



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:033143

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06326350

**C.nr.365/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Binak Duqi, dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh. B., numër personal ... me vendbanim në K. P., të cilin e përfaqëson i autorizuari S. K., avokat nga P., U. C..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga "N. G." pn., me objekt kontesti, kompensimin e shujtave(ushqimit), me vlerë të kontestit: **276.00 Euro**, jashtë seance me dt.19.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**- pa shqyrtim kryesor të çështjes -**

**I. APROVOHET** tërësisht kërkesëpadia e paditëses Sh. B nga P., **si e bazuar**, dhe:

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Sh. B. nga P., t’ia kompensojë në emër të shpenzimeve të shujtave (ushqimit) për periudhën kohore nga data (05.01.2021 deri më 21.11.2022), për 138 ditë të pranisë në punë, shumën prej 276.00 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 175.00 eurove, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit.

**III. REFUZHET** kërkesa e paditësit sa i përket llogaritjes se kamatës ligjore që ajo të paguhet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

**A r s y e t i m**

Paditësja Sh. B, me datën 07.02.2023 ka paraqitur padi kundër të paditurës për pagesën e shujtave (ushqimit), të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 10.10.2024, ashtu që ka kërkuar shumën e përgjithshme prej **276.00 Euro**.

Ka shtuar se është në marrëdhënie të rregullt pune të e paditura në vendin e punës mësimdhënës. Ka theksuar se e paditura përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata kolektive e Arsimit dt.18.04.2017 dhe 22.01.2021, dhe kontratës individuale nuk ka bërë pagesën e shpenzimit të ushqimit(shujtave). Njëjte e ka precizuar edhe me parashtrësën e datës 10.10.2024 ashtu që ka kërkuar shumën e përgjithshme prej 276.00 Euro për periudhën nga data 05.01.2021 – 21.11.2022 për 138 dite pune.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin e shumës së precizuar në emër të kërkesave të lartcekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi te datës 14.10.2024, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për pagesën e shujtave (ushqimit). Ka shtuar se paditësi fillimisht është dashur që këtë çështje ta inicioi në procedurë administrative, duke ju drejtuar të paditurës. Ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat kalimtare të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017, në nenin 46 të saj është paraparë se: MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët e këtij neni andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve. Ka theksuar se kjo kontrate kolektive sipas nenit 90.5 të LP – së vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës te cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara ne kontratën kolektive.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune si mësimdhënës shume vite përvojë pune, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit pagesën e shpenzimeve te udhëtimit për ditët e pranisë në punë, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, komform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht nenin 35 par.7 është paraparë se: *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të 22 punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhe të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 ( tri) vjet.”*, siç është dhe me këtë Kontratë (e cila ka qenë në fuqi komform nenit 45 par.2 të saj, deri me datën 22.01.2021), e që kjo çështje është rregulluar njëjtë dhe me dispozitat

e nenit 35 par.5 dhe 7 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat gjejnë zbatim në rastin e paditësit.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë vendosi duke u bazuar në Vërtetimin Nr. Protokollin ... i datës 09.10.2024 mbi ditët e pranisë në punë të paditëses lëshuar nga SHFMU "A. A." në S.-P., si dhe bazuar në Informatën e dhënë lidhur me prezencën në punë Nr.... të datës 18.12.2020 e lëshuar nga Komuna e Podujevës, Drejtoria e Arsimit për periudhën nga data 01.01.2021 deri me 21.11.2022, si provë, me ç' rast kemi të bëjmë me një dokument publik i cili ka fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtij dokumenti, e gjithë kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.7 të saj.

Andaj, në lidhje me kompensimin e ushqimit, gjykata e aprovoi kërkesëpadinë për 138 ditë, përkatësisht shumën prej 276.00 euro si të bazuar, duke e llogaritur si në vijim: 138 (ditët në punë) \* 2.00 € (shpenzimet në euro për një ditë) = 276.00 euro €, kjo duke u bazuar në kontratën kolektive ku përcaktohet se shpenzimet e ushqimit duhet të ju paguhen punonjësve të arsimit.

Gjykata i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e të paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa të shpenzimeve të udhëtimit dhe shujtave të ushqimit, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450, 452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 104 euro, precizimit të kërkesëpadisë në shumën prej 50.00 €, si dhe taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 21 eurove, gjithsejtë 175.00 €, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.365/2023, me datën 19.10.2024**

**Gjyqtari:  
Binak Duqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.